



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/24-7956 dt. 15/02/ 2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 22.01.2024, ora 10:00

Mbledhjen e kryesoi: Milnim Handari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës Rami Lladrovci, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend Dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 20.12.2023.
2. Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2023.
3. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve të qerdheve në Tërstenik dhe Nekoc.
4. Propozim Vendim për ndarjen dhe bashkimin e parcelave kadastrale.
5. Propozim Vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).
6. Raporti i punës së Kryetarit dhe i qeverisjes lokale për vitin 2023.
7. Raporti i punës së njësis së auditimit të brendshëm të Komunës së Drenasit për vitin 2023 dhe plani i implementimeve të rekomandimeve.
8. Raporti i performancës Komunale për vitin 2022.
9. Raport i komisionit për mbikqyrjen e realizimit të kontratave për dhënjën në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës të dhëna në shfrytëzim gjatë vitit 2020.
10. Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024.
11. Vendim për caktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit Komunal Aksionar NPL "PASTRIMI" SH.A.
12. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Nënëkryetari I Komunës Arben Shala- kemi edhe një pika shtesë për dhënien e një ari tokë, ka kërkuar Instituti Sizmologjik i Kosovës ka ba kërkesë

Muhamet gjoka- është pronë private ose pronë që është dhëna në shfrytëzim, ne ja kemi propozu tash mbetet me dërgua ata kërkesën. Vendi është në Kishnarek afër shkollës një hapësirë një ari tokë me kërkesë të Institutit që është në kuadër të Ministris së Financave, kordinatat që i kanë përcaktu ata ka dal që është pronë private edhe nuk mundemi me ja dhën dhe kërkesën e dytë kur ja kemi ba ka dal që ja kemi dhën kompanisë e TDI Ballkans në shfrytëzim për 99 vite është në procedur besoj për seanc të kuvendit ka me qen gati.

Arbër Halilaj- sa i përket rendit të ditës është bë dukuri që më shume të kemi pika shtes se sa pika që vinë në herën e par kur thirret mbledhjet qoft e KPF-së qoft mbledhja e kuvendit, kisha kërku që kjo mos të bëhet dukuri se po na përcjell më shumë se dy vite, pavarësisht qfar dokumenti raport apo propozim apo diqka tjetër është e pa pranushme që dokumentet me i marr në ditën e premte ndërsa mbledhja është të hënën. Ndërsa konkretisht rreth pikave. Lidhur me vendimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, do të duhej të kërkoja së pari një raport, por është aq i mangët sa që flet vetëm për tri prona të dhëna në shfrytëzim gjatë vitit 2020 ndërsa do të doja të kishim një raport të kompletuar me statusin e të gjitha pronave dhe me kryerjen e obligimeve ndaj Komunës dhe të gjitha elementet tjera për pronat e dhëna në shfrytëzim. po ashtu ky komision që e ka përpilu këtë raport duhet të kompletohet meqë dihet që anëtarja e komisionit z. Flora është pensionu një vitë ose dy vite pasi e ka nënshkrua këtë raport.

Florentina Elezi- edhe unë propozoj që të raporti për pronat që e keni bë për vitin 2020 mendoj që duhet me u përfshi edhe viti 2021 edhe ashtu e kemi kërku dy muaj më herët, na keni premtua që për muajin Janar keni me na e sjell një raport të mirëfilltë në lidhje me pronat, e presim gjithqysh në seancë.

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime Kryesuesi i Komunës Milaim Hajdari hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 02 vota (Për), kundër nuk pati, 04 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 20.12.2023.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2023.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve të qerdheve në Tërstenik dhe Nekoc.**

Muhamet Gjoka- realisht ne I kemi bërë për shkak se kërkohet bashkimi I parcelave për qerdhe në fshatin Nekoc kemi dasht me qen me një pikë të rendit të ditës për shkak sepse proceduralisht kërkohet që të miratohet edhe ndarja dhe bashkimi I parcelave domethan janë pronë publike një pjesë I merret shkollës një pjes mbrapa ambollantes domethën këtu ndërlidhen njëra me tjetrën. Ne kur I kemi propozu I kemi dërgu bashk në një pikë ndarje dhe bashkimi I parcelave

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Propozim Vendim për ndarjen dhe bashkimin e parcelave kadastrale.**

Meqë nuk pati diskutime tjera vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim Vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).**

Arbër Halilaj- kisha kerku që të shtohet si pikë e rendit të ditës raportimi për pronat e palujtshme të dhëna në shfrytëzim gjatë viteve 2020-2021, ky komision nuk është I kompletun është dasht me u kompletu me një zyrtar komunal

Nënëkryetari I Komunës Arben Shala - në bazë të ligjit jemi të detyrur me raportu, sigurisht se do të raportojm qështje për të

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 01 vota (Për), 6 kundër, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Raporti i punës së Kryetarit dhe i qeverisjes lokale për vitin 2023.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Raporti i punës së njësis së auditimit të brendshëm të Komunës së Drenasit për vitin 2023 dhe plani i implementimeve të rekomandimeve.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 06 vota (**Për**), 01 kundër , abstenim nuk pati

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Raporti i performancës Komunale për vitin 2022.**

Afrim Prokshi- edhe këtë vit Komuna e Drenasit është në listën e të parëve për performanc komunale me pikë jem të barabart me Komunën e Rahovecit, këtë vitë edhe pse jem në list nuk fitojm grant sepse raporti I auditorit ka dal I modifikun andaj nuk përfitojm mjete

Nënëkryetari I Komunës Arben Shala - auditimi ka tregu për shkak të obligimeve të kontratave kolektive

Azmine Gjoka- kontratat kolektive si keni realizu

Nënëkryetari I Komunës Arben Shala - ju mësimdhënsit keni qen shumë aktiv keni kërku më shumë mjete se komunat tjera, se ajo shkon me një shumë të caktuar nuk ka mundësi tjetër

Arbër Halilaj- u dasht me vepru sikur komunat tjera

Nënëkryetari I Komunës Arben Shala - edhe komunat tjera të njejt problem e kanë, ndoshta numri ka qenë më I vogël në komunën tonë viti 2022 ka qen vit I jashtzakonshëm me kërkesa të mëdha sepse sit ë arrihet një shumë e caktuar, ne atë e kemi kalu në qoftë se e kalon për një euro prap se prap diskualifikohesh prej grantit dotëthot raporti del I kualifikum

Azmine Gjoka- jo që unë nuk kam dëshir me pas një performanc të mirë për komunën ton po realiteti këtu po tregon, tjetër është me rregullu documentacionin se ato jan kritere tepër të ulta për me ba në një performanc, sepse ka shumë gjana që nuk janë të rregullune, po shihet kjar mos bani reklama me thanë jem të parët e realiteti nuk është kërkun

Nënëkryetari I Komunës Arben Shala - nganjëher është mirë me dal në komuna tjera me pa qysh është gjendja

Afrim Prokshi- nuk pajtohem me këtë kolegen me konstatimet e saj fare sepse këtu janë 119 tregus ne nuk guxojmë as një të dhën me vendos pa u verifiku në teren edhe pa qen e sakt edhe këtë vit lexone se qka kanë shkru verifikimi në teren për të siguruar vertetimin e të dhënave të raportuara dhe për të verifikuar zbatimin e tyre në teren një ekip e tyre e angazhuar, I ka kryer të gjitha inspektimet fizik dhe monitorimin e aktiviteteve në teren dotëthot edhe ne nuk kemi qen për grant ata janë dal I kan verifiku në shkolla, rrugët, ndriqimet I kane verifiku të gjitha sepse ne mundemi me dhën një të dhën po ata dalin në teren I verifikojnë ky është document zyrtar që I kanë bër verifikimin e tyre, ata pa e verifiku një të dhën në teren na e kthejn dotëthot bazohen në teren, ne kem ba ankes për do tregus vlere minimale për 0.2 edhe kur I kan verifiku prap u dal që

me të vertet është ajo e dhën që e kemi dërgu edhe e kan pranu aknesen tonë qdo punë që u kry shkruhet, përshembull te shtigjet për bicikleta kemi thën e kem zero

Azemine Gjoka- unë I kom pa kriteret se qka po kërkohet

Afim Prokshi- Kriteret e qasjes minimale kan qen pesë duhet me qen raporti I auditorit I pa modifikum, vendimet që I merrni në kuvend nëse kthehet ndonjë vendim I paligjishëm duhet të shfuqizohet edhe në qoftë se është e nevojshme prap me pru në Kuvend edhe me u miratu në bazë të kërkesës që kërkohet edhe raporti I performancës duhet me qen komplet I raportuar në kohën e duhur këto janë kriteret minimale që duhet mi plotsu pastaj vin në baz të tregusve sepse këto qka janë shenu këtu janë punë të kryme 100%

Nënëkryetari I Komunës Arben Shala- nëse ju kujtohet kur kemi pas me shfuqizu një vendim ju patem thën që ndikon në grant të performancës, ju patët apstenu a ju kujtohet presioni që e kemi pas, duke qen se është njëri ndër kriteret bazë bashk me bugjetin 75%

Hamit Haxhiu- realisht në aspektin parimor ashtu është se I ka indikator kryesor që e mat performancën, por te qytetarët e tonë nuk po I intereson aj indikator, qytetari I jonë e sheh infrastrukturen, e sheh ndërtimin, zhvillimin e qytetit, unë po pajtoj me at se indikator që e ka edhe demosi eshte krejt ne rregull edhe po besoj që jan plotësu qato kriteret ka administrat ka shteg të bicikletave po në aspect me qytetarin ton ata shohin diqka tjetër ,nese I marrin keta indikator kanalizimin, ujësjellësi, rruga, ndriqimi ,zvillimi I bizneseve une po pajtoj me juve ne rregull jemi

Afrim Prokshi- te kanalizimi qe e permende edhe ekonomik familjare jan te perfshira ne ekonomi familjare ne baze te shenimeve qe ikemi ne plateforme qe e ka ndertuar zyrtari I Gisit qeto jan te perfshine 98% I kemi te perfshir në siistem të kanalizimit ,ne ujesjelles I kemi 59 .19% për ujësjellës duhet ende me punu, ju e dini që tash jemi duke pritur edhe 22 fshatra që kane me hi ne system, edhe besoj qe tash rrjeti eshte kry dhe ka mbete dhe do finesa të vogla dhe mendoj që tash prej 59 ka me shku dikun 85%.

Hamit Haxhiu- dihet që ky raport është per vitin 2022 nuk është për vitin 2023 dhe dihet që veq për vitin 2022 ne kuvend e kemi bisedu janë permby 50% të fshatrave që skan sistem të ujit të pijës nuk është 59% por është nën 50%. Sistemin e ndriqimit në kohët e fundit ka marr nje evolim pak më të madh por nuk është që është plotësu pritshmeria e qytetarëve ose ka raste që këto janë tendenca politike, psh ta marrim Vasileva që nuk ka kanalizim, kqyrja gropat skeptike, as nuk ka ujësjellës I sheh qytetet tu bajt ujë me voza, e sheh sistemin e iberlepencit që rrezikohen femijët qdo herë sidomos verës mbushet plot, e kuptoj që iberlepenci nuk është qështje e Komunës po është rrethoja, p.sh bazeni I Vasilevës kur ka fillu ajo rrugë mu rregullu hala nuk eshte bere kurgjo në të

Shyqyri Bublaku- nëse e kqyrim modifikuimin e opinionit të autorit të përgjithshëm ka rrjedh prej kontratave kolektive ,kërkesat e mësimdhënëseve tonë që kanë berë dhe kjo ka arrit vleren gati 2 milion vjet dmth ne nuk kemi pas qasje të miefillt që me mbrojtë qytetarin ,nëse e ke lexu buxhetin të vitn kufinjet buxhetor per te gjitha kategorit ekonomike edhe kategoria ekonomike ,është e parapr mi mbulu pagat e rregullta të punëtorëve të arsimit dhe shnac nuk ki me rrit atë

shumë edhe me pas mjete të hyra vetanake, munëdesit për me I rrit kategorin e pagave I kemi 0 kërkesat qetash janë të juajat për gradim dikun vlera e tyre ka me qenë 2.5 milion e gjys, shanc nuk ki me tejkalu këte sisitem

Kryesuesi I Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- po pajtohem qe punëtorët e arsimit I kan marr mjetet, kerkush nuk ka drejt me than pse I kan marr nuk jau lejon ligji absolut është e drejte skurse qe nuk kemi të drejtë me paragjyku raportin e performancës, I ke marr paret ke pas të drejtë raporti është I drejt dhe nuk kemi të drejtë, edhe kaniher edhe pse mundemi me menu diqka tjeter kur thojm diqka e medndojm diqka tjeter edhe e pa pranushme, besoj viti 2023 ka me gene më mirë edhe ivestohet në Komunë me ose pa neve këto nuk nalen kështu ka funksionu edhe pas neve ka me funksionu

Muhamet Gjoka- meq po ndërlidhet me mësimdhënës si sqarim ose si njoftim sa I përket obligimeve të kontratës kolektive ju tham sinqerisht se qdo takim e kem ngrit në ministri personalisht I kom than edhe ministrit të mëhershëm ne kontratën kolektive veq po e vajtojn secili në Ministri veq e ka vajtu po na shkakton efekte po nuk ka ndërmarr asgja nëse ka vullnet me zgjidh këtë qështje kjo zgjidhet ndane një kod buxhetor qe Ministria e Financave mundet me kriju një kod të vëqant te kategorit ekonomike, unë ju kom tregu qe Komuna e Drenasit po don me I pagu obligimet e kontrates kolektive mësimdhënësve dhe punorëve shëndetsor po e sakrifikojm rrugen për Berishë përshembull nuk po shtrojm hiq po i paguajm opligimet po e tham hipotetikusht po nuk kem I pas të drejt prap na kish dal me bo pagesen ashtu opinion I auditorit na kish dal I modifikum keqklasifikum këtë e kan diskutu edhe zyra e auditimit qe qysh me klasifiku a me klasifiku a jo për shkak se ka qen diqka qe nuk është nvar prej vullnetit të Komunës ka qen jasht domenit të komunës seciles komunë, mirëpo ata kan vendos përshkak qe është në standard ndërkomtare të kontabilitetit, kanë vendos me I rrespektu për her të par në vitin e kalum domethan nuk e kanë marr parasysh pages aka pas edhe herave tjera tash cilen komunë e ka prek kjo është ato qe kanë pas në raport me buxhetin total qe kan pas më së shumti shpenzime kjo ka variru do I kan marr pak më herët, do ankesa I kan shty I jan grumbullu I kan marr si përnjëher domethën ka ndodh ajo edhe fatmirësisht vitin e kalum po besoj qe I kemi shpëtu keqklasifikimit në bazë të raporteve tona tash duhet me pa auditori po flas për vitin 2023 mirëpo sa I përket obligimeve të kontratës kolektive ne qdo her në takim në Ministri e kemi ngrit këtë qështje, ne ju kemi thën ose gjeni një zgjidhje caktone një kod buxhetor, Ministria ka mujt mi nda 500 mij euro me kriju kodin edhe tjerat mi than Komunës plotsone atëher na kish mbet te ne me ba zgjidhje edhe mi kry obligimet te planifikimi I bexhetit me sakrifiku naj project edhe në mënyr qe me planifiku në kategorin qe është e caktume për obligime të kontratës kolektive Qeveria ka vendos me ndërpre kontratën kolektive edhe e ka ndërpre

Arbër Halilaj-në pikën 7 po shihet qe kemi prezente edhe njësin e auditimit sa I përket detajeve indicator edhe pse po shihet qe ndikimi kryesor është I kontratës kolektive por kishim mujt me përgadit pyetje të ndryshme për shefin e auditimit të brendshëm edhe në seanc me I diskutu detajet

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nënë të rendit të ditës: **9. Raport i komisionit për mbikqyrjen e realizimit të kontratave për dhënjën në shfrytëzim të pronave të palujtshme të Komunës të dhëna në shfrytëzim gjatë vitit 2020.**

Hamit Haxhiu- unë kisha thënë që raportin përveq vitit 2020 me ja shtu edhe vitin 2021 në qoftë se vjen me ndryshim jem në rregull

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Vendim për caktimin e kompenzimit të anëtarëve të komisionit komunal aksionar NPL "PASTRIMI" SH.A.**


Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës: **12. Të ndryshme.**

Florentina Elezi- kam një pyetje në lidhje për shtesat për lehonat edhe për kopshtet që e kemi votu e kemi shti nbuxhet po nuk është ka realizohet a bon me dit veq a banë me dit qysh është situata.

Shyqiri Bublaku- buxheti për vitin 2024 nuk është alokuar akoma edhe po u aloku buxheti nuk ka mundësi mu ba asnjë pages.

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 10:50 min .

Procesmbajtëse:



Indira Olluri Thaçi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari